



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr.256, datë 12.11.2019

PËR
KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT JOGJYQATAR Z. {...} DHE VIJIMIN E
PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES PËR EMËRIM SI GJYQATAR NË GJYKATËN E
LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 12.11.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z.{...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit z.{...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.110, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :

- I. Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës penale.*
- II. Afati i kandidimit*
 - 1. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

2. Brenda afatit dyjavor nga dita e publikimit të vendimit si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për pozicionin e lirë të shpallur përmes vendimit me sipër, ka aplikuar për të marrë pjesë edhe z. {...} (më poshtë referuar si kandidati).

3. Me Vendimin nr.142, datë 26.07.2019, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur :

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat që ka dorëzuar kërkesën për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, si më poshtë: ...; 19. Për z. {...}- relator z.Alban Toro; ...”.

4. Më datë 26.07.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit treditör, kandidati depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Më datë 29.07.2019, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, duke vlerësuar se ky dokumentacion nuk ishte i plotë (mungonte certifikata personale), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019.

7. Po më datë 29.07.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatit iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit pesëditor, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, ndërsa brenda datës 06.09.2019 të caktuar me Vendimin nr.142, datë 26.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ai dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit

të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

9. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datat 06.08.2019 dhe 07.08.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për z. {...}.

10. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

11. Më datë 06.08.2019, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit, atij “të pasjes gradë shkencore në drejtësi”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji i Statusit), me Shkresën nr. 4163 prot., u kërkua informacion dhe konfirmim nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në lidhje me fitimin e gradës shkencore në drejtësi nga kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, ndër ta edhe për z. {...}.

12. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka dërguar informacionin dhe konfirmimin përkatës, ndër të tjerë edhe për kandidatin z. {...}, me Shkresën nr. 7834/1 prot., datë 23.08.2019, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 4163/1 prot., datë 26.08.2019 (siç do të përshkruhet më poshtë).

13. Po më datë 06.08.2019, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit “të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit të Statusit, por edhe të kriterit “të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”, përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, neni 49 në lidhje me shkronjë “dh” të nenit 28, të Ligjit të Statusit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet shtetërorë dhe private që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidatit, subjekte të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

14. Po në kuadër të verifikimit të kushtit dhe kriterit të kandidimit si më lart (sipas pikës 13), më datë 06.08.2019, u kërkua informacion në lidhje me punësimin e kandidatëve, ndër ta edhe për z. {...}, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

15. Më datë 30.08.2019, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit “të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit të Statusit, përmes shkresave të veçanta u kërkua informacion dhe dokumentacion për kandidatët, ndër ta edhe për z. {...}, nga disa parti politike kryesore në vend. Këto të fundit kanë përcjell informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

16. Po në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit si më lart (sipas pikës 15), më datë 24.10.2019, u kërkua informacion nga gjykata e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, sa i përket kandidatit z. {...} ka përcjell informacionin e saj më datë 28.10.2019, siç do të përshkruhet më poshtë.

17. Në vijim të verifikimit, në lidhje me kriterin e pasjes nga kandidati të zotësisë për të vepruar, përcaktuar në nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit, më datë 24.10.2019, u kërkua informacion nga gjykata e vendbanimit të kandidatit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka përcjell informacionin e saj më datë 25.10.2019, siç do të përshkruhet më poshtë.

18. Së fundi, gjatë verifikimit, po në lidhje me kriterin e pasjes nga kandidati të zotësisë për të vepruar, përcaktuar në nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit, më datë 25.10.2019, u kërkua informacion nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, e cila ka përcjellë informacionin e saj më datë 30.10.2019, siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE TË KANDIDIMIT/EMËRIMIT SI GJYQTAR I GJYKATËS SË LARTË

1. Kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përcaktohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 136, pikat 3 dhe 4. Sipas rregullimeve në këto pika të kësaj dispozite, “3. *Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi. 4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteria të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj”.*

2. Po ashtu, kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, janë përcaktuar edhe në Ligjin e Statusit, nenin 49 (“Emërimi i kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë”), pikat 1 dhe 2, shkronja “b”. Sipas rregullimeve në këto pika të kësaj dispozite, “1. *Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë*

ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. 2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: ...; b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”.

3. Konkretisht, për kandidatin z. {...} u verifikuan këto kushte kandidimi/emërimi:

a) qenia jurist.

a.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar (të njëzuar me origjinalin) dokumentin Diplomë nr. 1650.B, me nr. regjistri 1356, lëshuar më datë 25.06.1986, nga Universiteti i Tiranës, sipas të cilit kandidati {...}, në periudhën 1982 - 1986, ka kryer kursin e plotë të Fakultetit të Shkencave Politike e Juridike të Universitetit të Tiranës në Degën “Drejtësi” dhe me vendim të komisionit shtetëror të datës 25.06.1986 i është dhënë titulli “Jurist”. Bashkëngjitur Diplomës është dhe dokumenti (i njëzuar me origjinalin) “Lista e Rezultateve të Provimeve”, lëshuar më datë 05.07.1986, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike e Juridike.

b) përvoja profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.

b.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar dokumentin “Librezë Pune”, sipas të cilit kandidati ka përvojë profesionale si avokat, lektor i së drejtës dhe jurist i nivelit të lartë në administratën publike. Konkretisht, në mënyrë kronologjike, përvoja profesionale e kandidatit sipas dokumentit “Librezë Pune” është si vijon: “Hetues” në Hetuesinë e Rrethit Krujë, për periudhën 16.08.1986 - 15.01.1991; “Hetues” në Hetuesinë e Rrethit Tiranë, për periudhën 16.01.1991 - 01.11.1991; “Specialist” në Ministrinë e Drejtësisë, për periudhën 01.11.1991 - 14.04.1994; “Avokat” për periudhën 01.04.1994 - 31.12.1997; “Pedagog” në Shkollën e Magjistraturës, për periudhën 21.09.1997 - 07.06.1999; Ministër i Drejtësisë për periudhën 10.06.1999 - 13.07.2000; “Avokat” për periudhën 01.01.2002 - 31.12.2002; Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 14.11.2002 - 14.11.2007; “Pedagog” në Universitetin “Marin Barleti”, për periudhën 16.05.2009 pa datë mbyllje.

b.2 Gjatë verifikimit, referuar subjekteve ku kandidati figuronte të kishte qenë i punësuar sipas dokumentit “Librezë Pune”, iu kërkua dhe ato dërguan informacion për të dhënat e punësimit të kandidatit. Konkretisht:

me Shkresën nr. 2151/1 prot., datë 08.08.2019, Prokuroria e Përgjithshme informon se kandidati “*ka kryer detyrën e hetuesit në Hetuesinë e Rrethit Krujë dhe Tiranë, për periudhën 16.08.1986 - 01.11.1991*”;

me Shkresën nr. 5884/1 prot., datë 16.08.2019, Ministria e Drejtësisë informon se kandidati “*ka punuar pranë Ministrisë së Drejtësisë në pozicionet dhe periudhat sa më poshtë: - Në*

datën 01.11.1991, është emëruar Inspektor në Drejtorinë e Kodifikimit; - Në vitin 1993, ka ndryshuar emërtim pozicioni nga Inspektor në Specialist në Drejtorinë e Kodifikimit deri në datën 14.04.1994, ku është liruar nga kjo detyrë me kërkesën e tij. / Data e ndryshimit të pozicionit Inspektor në Specialist në Drejtorinë e Kodifikimit në vitin 1993, nuk mund të identifikohet; - Nga data 04.06.1999 - 07.07.2000, ka kryer detyrën e Ministrit të Drejtësisë”;

me Shkresën nr. 378/2 prot., datë 13.08.2019, Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë informon se kandidati “*ka fituar titullin avokat dhe është mbajtes i licencës nr. 145, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, përpara vitit 2000, periudhë për të cilën nuk disponojmë dokumentacion, pasi deri në atë periudhë avokatia ka pasur vartësi nga Ministria e Drejtësisë. / ... për periudhën pas këtij viti subjekti në fjalë figuron në regjistrin e avokatëve pasiv të Republikës së Shqipërisë për shkak të papajtueshmërisë ligjore për ushtrimin e profesionit të avokatit, parashikuar sipas nenit 7 të ligjit 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, pasi ka ushtruar funksione pranë administratës publike”;*

me Shkresën nr. 701/1 prot., datë 15.08.2019, Shkolla e Magjistraturës informon se kandidati “*ka qenë pedagog i brendshëm në Programin e Formimit Fillestar gjatë periudhës 1997 - 1999 dhe më pas pedagog i jashtëm për periudhën 1999 - 2007 dhe 2015 e në vazhdim, si dhe ekspert në Programin e Formimit Fillestar Vazhdues nga viti 2012 e në vazhdim, në Shkollën e Magjistraturës”;*

me Shkresën nr. 2695 prot., datë 09.08.2019, Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti” informon se kandidati “*punon si pedagog pranë SHLUI “Universiteti Marin Barleti” që nga viti 2009”.*

b.3 Po ashtu, gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Konkretisht:

me Shkresën nr. 15071/1 prot., datë 13.08.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ndër të tjera, informon se “*Për shtetasin {...}... për efekt burim to ardhura nga paga, rezulton të ketë punuar ose/dhe punon pranë subjektit: 1. Shkolla e Magjistraturës - Pedagog 2. Barleti Group - Pedagog”.* Bashkëlidhur kësaj shkrese është dërguar dhe një kopje-historiku i punësimit sipas ESIG027, kopje-ekstrakti historik i punonjësit, me të gjithë të dhënat shifrore të pagës, sigurimeve shoqërore e shëndetësore, kontributet përkatëse dhe TAP për çdo muaj, vit dhe subjekt/institucion punëdhënës, në të cilin ka punuar dhe/ose punon kandidati. Në historikun e punësimit sipas ESIG027 pasqyrohet punësimi i kandidatit në Shkollën e Magjistraturës (me kohë të pjesshme) gjatë periudhës 2015 - 2019, si dhe në “Barleti Group” për periudhën Dhjetor 2011 dhe në vijim. Ndërsa në ekstraktin historik të punonjësit pasqyrohet punësimi i kandidatit në “Barleti Group” për periudhën Dhjetor 2011 - Korrik 2019, si dhe në Shkollën e Magjistraturës, për muaj të ndryshëm gjatë periudhës 2015 - 2019;

me Shkresën nr. 5744/1 prot., datë 09.08.2019, Instituti i Sigurimeve Shoqërore informon për të dhëna punësimi të kandidatit për periudhën 2012 e në vijim, referuar të dhënave të nxjerra nga sistemi informatikë i saj, që dispononte të dhëna për kontributet që mblidheshin dhe dërgoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Web Service, të dhëna këto

që disponoheshin nga viti 2012 dhe në vijim. Sipas të dhënave të dërguara përmes kësaj shkrese, jepen të njëjta të dhëna punësimi të kandidatit sikundër ato të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si më lart;

me Shkresën nr. 8468 prot., datë 19.09.2019, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, informon për të dhënat e punësimit të kandidatit për periudhën 1994¹ - 2012, si vijon: si i punësuar “person fizik” për periudhat Prill 1994 - Dhjetor 1997 dhe Janar 2002 - Dhjetor 2002; si i punësuar në Ministrinë e Drejtësisë për periudhat Janar 1994 - Prill 1994 dhe Qershor 1999 - Qershor 2000; si i punësuar në Shkollën e Magjistraturës për periudhën Shtator 1997 - Maj 1999; si i punësuar në Këshillin e Lartë të Drejtësisë për periudhën Janar 2003 - Nëntor 2007, si dhe si i punësuar në Universitetin Marin Barleti për periudhën Maj 2009 - Dhjetor 2012.

b.4 Sipas të dhënave të grumbulluara, kandidati del të ketë përvojë profesionale deri në momentin e kandidimit si vijon: si avokat - 3 vjet e 5 muaj e 15 ditë; si lektor i të drejtës (me kohë të plotë) - 11 vjet e 11 muaj; si jurist i nivelit të lartë në administratën publike - 12 vjet e 9 muaj². Në total, kandidati ka përvojë profesionale me kohë të plotë si avokat, si lektor i të drejtës dhe si jurist i nivelit të lartë në administratën publike përmbi 28 vjet.

c) pasja gradë shkencore në drejtësi.

c.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar dokumentin “Diplomë Dokorate” nr.427 (Nr. i Regjistrimit të KVTA 385 dhe Nr. i Regjistrimit 10B), lëshuar më datë 13.09.2011, nga Universiteti i Tiranës, sipas të cilit “Z. {...}fiton Gradë Shkencore “Doktor” në Penale”.

c.2 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga ministria përgjegjëse për arsimin, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila, me Shkresën nr. 7834/1 prot., datë 23.08.2019, informoi dhe konfirmoi, ndër të tjera, se:

“... 6. Grada shkencore “Doktor” në “Penale” e fituar nga z. {...}figuron e regjistruar ne regjistrin e KVTA-së për Gradën Shkencore: “Doktor” me numër rendor: 385, Universiteti i Tiranës, Nr. Vendimi: 44, datë 28.07.2011. ... Të gjitha gradat shkencore të listuar më sipër, përveç gradës shkencore te fituar nga ..., i përkasin fushës së drejtësisë”.

ç) mbajtja e funksione politike në administratën publike gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

¹ Koha kur ka filluar zbatimi i Ligjit nr. 7703, date 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” sipas të cilit, për përfitim të mbrojtjes nga sigurimet shoqërore, organet e sigurimeve shoqërore grumbullonin dokumentacionin për veprimtaritë ekonomike të të punësuarve dhe mblidhnin kontributet e paguara të sigurimeve shoqërore.

² Këtu nuk përfshihet periudha e punësimit si Ministër i Drejtësisë.

ç.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim të datës 22.07.2019, nëpërmjet të cilës përkundrejt përgjegjësisë ligjore ka deklaruar se *“nuk kam mbajtur funksione politike në administratën publike, ..., gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”*.

ç.2 Gjatë verifikimit, për këtë kusht kandidimi/emërimi u morën dhe vlejën të dhënat e informacioneve sipas pikës b), Kreu II, të këtij vendimi. Nga këto të dhëna rezultoi që kandidati ka mbajtur një funksion politik në kuptim të nenit 2, pika “ç”, të Ligjit të Statusit, pikërisht atë të “Ministrit” (Ministrit të Drejtësisë). Këtë funksion kandidati e ka mbajtur gjatë periudhës 10.06.1999 - 13.07.2000, periudhë kjo që daton përtej 10 viteve të fundit para kandidimit, saktësisht para më shumë se 19 viteve.

d) mbajtja e pozicioneve drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

d.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim të datës 22.07.2019, nëpërmjet të cilës përkundrejt përgjegjësisë ligjore ka deklaruar se *“nuk kam mbajtur ... pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”*.

d.2 Gjatë verifikimit, për këtë kusht kandidimi/emërimi u kërkuan dhe morën të dhëna nga disa parti politike kryesore në vend. Konkretisht:

me Shkresën nr. 220 prot., datë 12.09.2019, Partia Socialiste e Shqipërisë informon se z. {...} nuk ka qenë anëtar ose i zgjedhur në organet drejtuese të Partisë Socialiste të Shqipërisë;

me Shkresën nr. 152 prot., datë 20.10.2019, Partia Demokratike e Shqipërisë kërkoi të dhëna shtesë/më të plota për individualizimin e kandidatëve (atësi, amësi, ditëlindje, vendlindje), ndër ta edhe për z. {...}, me qëllim dhënien e informacionit të kërkuar;

me Shkresën nr. 337/1 prot., datë 19.09.2019, Lëvizja Socialiste për Integrim informon, ndër të tjera, se z. {...} nuk ka qenë anëtar i Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe as pjesë e organeve të saj drejtuese;

me Shkresën nr. 78 prot., datë 05.09.2019, Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet informon, ndër të tjera, se z. {...} nuk ka qenë anëtar apo pjesë e organeve drejtuese të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) që nga themelimi i saj.

d.3 Gjatë verifikimit, për këtë kusht kandidimi u kërkua dhe u mor informacion nga gjykata e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me Shkresën nr. 847/4 prot., datë 28.10.2019, sa i përket kandidatit z. {...}, ka informuar se *“nuk rezultoi të ketë qenë pjesë e organeve drejtuese të partive politike”*.

4. Nga sa rezulton, kandidati z. {...} plotëson kushtet e kandidimit/emërimit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të përcaktuara në nenin 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pikat 1 dhe 2, shkronja “b”, të Ligjit të Statusit.

III. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT/EMËRIMIT SI GJYQTAR I GJYKATËS SË LARTË

A. Për kriteret sipas nenit 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit

1. Disa nga kriteret e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përcaktohen në Ligjin e Statusit, neni 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”.

1.1 Sipas nenit 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit, *“2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "ë" dhe "f", të nenit 28, të këtij ligji; ...”.*

1.2 Ndërsa sipas nenit 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të Ligjit të Statusit, që parashikon kriteret e pranimit në formimin fillestar dhe bën pjesë në institutin e rekrutimit të kandidatëve magjistratë, *“Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t'u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) ka zotësi të plotë për të vepruar; b) është shtetas shqiptar; ...; d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë; dh) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi; ...; ë) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete”.*

2. Konkretisht, për kandidatin z. {...} u verifikuan këto kriteret kandidimi/emërimi:

a) zotësia e plotë për të vepruar.

a.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi u mbajt në konsideratë se “zotësia për të vepruar”, si kategori juridike që i takon individit, gjen rregullim në legjislacionin civil (Kodin Civil), ndërsa i njëjti kuptim për të konsiderohet edhe kur individ është subjekt i të drejtës publike. Zotësia për të vepruar nënkupton aftësinë e personit për të qenë bartës i të drejtave dhe detyrimeve. Zotësia për të vepruar fitohet me arritjen e moshës 18 vjeç dhe, sipas ligjit, pasja e kësaj zotësie prezumohet deri në vërtetimin e heqjes apo kufizimit të saj me vendim gjyqësor të formës së prerë.

a.2 Nisur nga kuptimi i nocionit të “zotësisë për të vepruar”, referuar moshës së kandidatit, ai del ta ketë fituar këtë zotësi, ndërsa prezumohet ta ketë atë përderisa gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë. Me Shkresën nr. 8407/2 prot., datë 25.10.2019, gjykata e vendbanimit të kandidatit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor

Tiranë, informon se nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ndërsa me Shkresën nr. 2659 prot., datë 30.10.2019, Dhoma Kombëtare e Noterisë, informon se nga verifikimi i bërë i listës së personave të cilëve iu është hequr zotësia për të vepruar, rezulton se kandidati z. {...} nuk figuron në atë listë. Përtej kësaj, nga të dhënat e punësimit të kandidatit del që ai të jetë në marrëdhënie pune, në profesionin e pedagogut, çka indirekt nënkupton pasjen nga ai të zotësisë së plotë për të vepruar, përderisa kjo e fundit është një nga elementet e aftësisë për të kontraktuar në një marrëdhënie juridike pune, element ky i verifikueshëm në vijimësi në kuadër të ekzistencës së kësaj marrëdhënie.

a.3 Sa më lart, referuar moshës së kandidatit, del që ai ta ketë fituar zotësinë juridike, ndërsa prezumohet ta ketë atë përderisa gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë.

b) shtetësia shqiptare.

b.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar dokumentin “Kartë Identiteti”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 06.02.2019, ku pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, konkretisht “shqiptare”.

b.2 Gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidat. Përkundrazi, nga Certifikata Elektronike Personale printuar në letër më datë 29.07.2019, konstatohet se kandidati vijon të ketë shtetësinë shqiptare.

c) gjendja gjyqësore.

c.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar dokumentin “Vërtetim i gjendjes gjyqësore”, me nr.7 prot., datë 18.07.2019, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sipas të cilit kandidati figuron i padënuar penalisht.

c.2 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore), e cila, me Shkresën nr. V-2595/1 prot., datë 09.08.2019, ndër të tjera, informon se nga verifikimi i bërë në Regjistrin Themeltar të Gjendjes Gjyqësore, kandidati rezulton i padënuar nga gjykatat penale shqiptare.

ç) disiplina në punë.

ç.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 22.07.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se “*gjatë karrierës time profesionale nuk jam larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk kam marrë dhe as nuk kam asnjë masë disiplinore*”.

ç.2 Po ashtu, në rastin e aplikimit, siç u përmend edhe më lart, kandidati ka depozituar dokumentin “Librezë Pune”, nga verifikimi i të cilës, në rubrikën “Shkaku i largimit nga puna”, nuk pasqyrohet në asnjë rast që kandidati të jetë larguar nga puna për shkaqe disiplinore.

ç.3 Gjithashtu, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar një Vërtetim datë 19.07.2019, lëshuar nga Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti” (punëdhënësi aktual), përmes të cilit vërtetohet se kandidati punon si pedagog prej vitit 2009 dhe se “*Që nga koha kur ka filluar punë ndaj z. {...} nuk është marrë ndonjë masë disiplinore dhe nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi*”.

ç.4 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga të gjithë subjektet shtetërore dhe privatë, ku kandidati ka punuar dhe punon aktualisht. Informacionet e përcjella nga këto subjekte janë evidentuar në nënndarjen b.2, shkronja “b”, pika 3, Kreu II, të këtij relacioni. Konkretisht:

me Shkresën nr. 2151/1 prot., datë 08.08.2019, Prokuroria e Përgjithshme informon se kandidati “*gjatë ushtrimit të detyrës nuk rezulton që të ketë marrë masa disiplinore*”;

me Shkresën nr. 5884/1 prot., datë 16.08.2019, Ministria e Drejtësisë informon se kandidati “*nuk është larguar nga puna për shkaqe disiplinore*”;

me Shkresën nr. 378/2 prot., datë 13.08.2019, Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë informon se për kandidatin “*nuk figurojnë masa apo procedime disiplinore*”;

me Shkresën nr. 701/1 prot., datë 15.08.2019, Shkolla e Magjistraturës informon se për kandidatin “*nuk është marrë asnjë masë disiplinore*”;

me Shkresën nr. 2695 prot., datë 09.08.2019, Shkolla e Lartë Universitare Jopublike “Universiteti Marin Barleti” informon se kandidati “*nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, ndaj tij nuk është marrë ndonjëherë masë disiplinore dhe nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi*”.

d) qenia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990.

d.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 22.07.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se “*nuk kam qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990*”.

d.2 Gjatë verifikimit, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 30.07.2019, kandidati dorëzoi të plotësuar formularin e aplikimit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

d.2 Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjell në Këshill, me Shkresën nr. 1118/4 prot., datë 04.09.2019, Vendimin nr.555 datë 04.09.2019, me të cilin është vendosur: “*Të informojë institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për informacionin që kërkohet me shkresën*”.

nr. 3997/9 prot., datë 09.08.2019, “Kërkesë për verifikim”, të pastërtisë së figurës, përpara emërimin të kandidatit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur, se nga verifikimet e kryera deri tani për zotën {...} nuk rezultoi : a) të ketë qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991, në zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas përcaktimeve të nenit 29 të Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

dh) qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

dh.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 22.07.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se “nuk kam qenë dhe nuk jam bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete”.

dh.2 Gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit edhe të kriterit të figurës së kandidatit, u kërkua dhe u mor informacion nga organet ligjzbatuese, nga të cilat nuk u bë prezent ndonjë e dhënë për qenien e kandidatit bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

3. Nga sa rezultoi, kandidati z. {...} plotëson kriteret e kandidimit/emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të përcaktuara në nenin 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit.

B. Për kriterin e pasurisë sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit të Statusit

1. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 5, të nenit 49³ në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32⁴, të Ligjit të Statusit.

³ “5. Këshilli vlerëson përmbushjen e kriterëve, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, dhe verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. Kandidatët, të cilët nuk përmbushin kriteret ose nuk kalojnë procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi”.

⁴ “2. ..., për secilin kandidat ..., Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet ... kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë së kandidatit, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 102/26 prot., datë 09.10.2019.

2.1 Sipas Raportit të ILDKPKI-së, kandidati ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

2.2 Po ashtu, sipas Raportit të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit është kryer kontroll i plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati, duke konkluduar se:

- a) deklarimi i kandidatit është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) kandidati ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) kandidati nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) kandidati nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3. Për verifikimin e kriterit të pasurisë së kandidatit u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

3.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 15071/1 prot., datë 13.08.2019, ku për kandidatin z. {...}, krahas të dhënave në lidhje me punësimin të parashtruara më lart, referohet se nuk figuron i regjistruar në organin tatimor me aktivitet tregtar. Po ashtu, referohet e dhëna se kandidati figuron të jetë pjesëtar i bordit të menaxhimit të subjektit “Veneto Banka”, me Nipt J71928004K, që në datë 04.04.2018. Gjithashtu referohet e dhëna se kandidati ka qenë pjesëtar i bordit të menaxhimit të subjektit “Intesa San Paolo Bank”, me Nipt J81817006P, nga data 29.03.2016 deri me datë 23.03.2019.

3.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 20339/1 prot., datë 26.08.2019, ku për kandidatin z. {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit. 5. ..., Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. ...”.

4. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë. Të dhënat e referuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve rezultojnë të jenë deklaruar nga ana e kandidatit, si dhe të kenë qenë pjesë e kontrollit të plotë, nga ILDKPKI-ja, të pasurisë, asetëve dhe interesave të deklaruar nga kandidati.

5. Nga të dhënat e përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, por edhe nga ato të përftuara nga korrespondenca e saj me subjekte shtetërore dhe private, dokumentacion ky që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe nga analiza financiare e bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik", i ndryshuar, konstatohet se Raporti është i plotë, i detajuar dhe i qartë, duke mos paraqitur ndonjë mangësi.

6. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit të Statusit, për kandidatin janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për atë nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi sa i përket këtij kriteri. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

C. Për kriterin e figurës sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit të Statusit

1. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 5, të nenit 49 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës së kandidatit, u kërkuar raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk është ngritur ende.

3. Nga raportimet e institucioneve ligjzbatuese nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit me persona të përfshirë në krimin e organizuar

apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

4. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës, kandidatit iu kërkua dhe ai plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 30.07.2019, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të dhënave të tij në lidhje me figurën dhe integritetin.

5. Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjell në Këshill, me Shkresën nr. 2153/59 prot., datë 07.10.2019, Vendimin “Për rezultatet e verifikimit për subjektin {...}”, sipas të cilit është vlerësuar se “*Subjekti deklarues {...}, kandidat për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

6. Nga formulari i vetëdeklarimit të kandidatit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ashtu edhe nga Vendimi i Prokurorisë së Përgjithshme “Për rezultatet e verifikimit për subjektin {...}”, nuk del që kandidati: të ketë qenë ndonjëherë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj; të jetë dënuar me burgim me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë; të ketë qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale; të ketë qenë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale; të ketë qenë ndonjëherë nën ndonjë masë shtrënguese sigurimi personal; të ketë qenë ndonjëherë në kërkim në bazë të ndonjë urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale; të jetë dëbuar nga një shtet i huaj.

7. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 6585/1 prot., datë 22.08.2019, ka dërguar në Këshill një informacion me të dhënat për përbërësit e gjendjes civile, ndër të tjerë edhe për kandidatin z. {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile. Sipas informacionit të dërguar, kandidati nuk ka kryer ndryshime të përbërësve të gjendjes civile.

8. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi ka kryer verifikimet e rastit, nuk ka konstatuar mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidati në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të

personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Për pasojë, nuk ka pasur vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

9. Nga verifikimi i kriterit të figurës sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit të Statusit, për kandidatin janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për atë nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi sa i përket këtij kriteri. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkuara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin mbi të cilën të ngrihen dyshime për papranueshmërinë e kandidimit të tij për gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

IV. KONKLUZIONE

1. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

2. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 136, pikat 3 e 4 dhe në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “c” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 49, pikat, 1, 2 dhe 5 në lidhje me nenin 32 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i

ndryshuar, në nenin 61, pika 2, shkronja “c”, në nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “e”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatit jogjyqtar z. {...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR